



## NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

### PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË NË FAKULTETIN E DREJTËSISË, NË UNIVERSITETIN “LUARASI”, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Universiteti “Luarasi”, në zbatim të Urdhrit të Rektorit Nr. 3, datë 16.07.2020 “ Për punësimin e personelit akademik me kohë të plote për vitin akademik 2020 – 2021, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Departamentin e së Drejtës Penale të Fakultetit të Drejtësisë:

#### Përshkrimi i vendit të punës

Personeli akademik me kohë të plotë që do të punësohet do të anagazhohet në mësimdhënie në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”, në fushën e së Drejtës penale, në Departamentin e së Drejtës Penale të Fakultetit të Drejtësisë.

#### Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të jetë i aftë të garantoj standardin e cilësisë dhe efikasitetin në mësimdhënie.
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional me kolegët dhe studentët;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- Të ketë eksperiencë në punë.

#### Kriteret bazë:

1. Të ketë minimum gradën shkencore “Doktor i shkencave” në fushën e Drejtësisë;
2. Të ketë përfunduar studimet universitare 4-vjeçare, 5-vjeçare ose (3+2)-vjeçare në fushën e Drejtësisë, me kohë të plotë;
3. Të ketë së paku 5-vite eksperiencë në mësimdhënie në Institucionet e Arsimit të Lartë, brenda apo jashtë vendit, në fushën e të Drejtës Publike.

#### Dokumentacioni i kërkuar

- 1) Kërkesë me shkrim drejtuar Universitetit “Luarasi”
- 2) Fotokopje të diplomave, dhe të çertifikatës/ave së notave të noterizuar/a. (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- 3) Dy letra rekomandimi dhe të paktën një nga letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
- 4) Nëse ka eksperiencë të mëparshme në mësimdhënie, një nga letrat e rekomandimit të jetë nga titullari i IAL;
- 5) Fotokopje të dëshmimeve kualifikimi të ndryshme, si dhe të publikimeve dhe të pjesëmarrjes në Konferenca Shkencore.
- 6) Fotokopje të kartës së identitetit, ose ndonjë dokumenti tjetër identifikimi;
- 7) Fotokopje të librezës së punës, nëse ka, apo vetëdeklarim punësimi ose vetëdeklarim si i punësuar;
- 8) Fotokopje e noterizuar e dëshmisë së zotërimit të gjuhës së huaj;

Skualifikohen dhe nuk kalojnë në fazën e dytë, thirrjen në intervistë, ata aplikantë të cilët paraqesin dokumenta të pa noterizuara, ose kanë mangësi në dokumentacionin e kërkuar.

Dokumentat duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar ose dorazi në adresën:

**Universiteti “Luarasi”, Tiranë.**

**Adresa: Rruga e Elbasanit, Nd. 59, H.1**

**Njësia Administrative Nr.2, Kodi Postar 1010**

**Tiranë, Shqipëri**

**Aplikim për Staf Akademik në Universitetin “Luarasi”**

Afati për dorëzimin e dokumentave është nga deri më **datë 28.08.2020** .

Për më shumë informacion ju lutem kontaktoni:

Zyrën e Burimeve Njerëzore të Universitetit “Luarasi” në adresën:

Email: [vasilika.mulla@luarasi-univ.edu.al](mailto:vasilika.mulla@luarasi-univ.edu.al) ose [info@luarasi-univ.edu.al](mailto:info@luarasi-univ.edu.al)

Mob: + 355 688030950